
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Për: Mendim M <meendi.m@outlook.com>

Nga : Drejtoria e Urbanizmit, Komuna e Prishtinës

Subjekti: Përgjigje për banorin e lagjes “Sofalia” që është kundër ndërtimit të pompës së derivateve me restaurant në parcelën kadastrale 10421-2, Z.K Prishtinë, pranë shkollës “Gjin Gazuli” në lagjen “Sofalia” në Prishtinë.(Njoftimi publik nr. 05 Nr. 351/02-233307/21/01 dt. 07.06.2022 i vendosur prej dt.05.08.2022 deri më 19.08.2022)

Data: 14.10.2022

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, vepron në bazë të rregullativës ligjore, i zbaton Planet Rregulluese dhe Rregulloret në fuqi. Në këtë rast do të veprojmë në bazë të kriterëve të përcaktuara me “Rregulloren për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik, Nr. 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014” duke respektuar rrugët e planifikuara sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-247790 të dt. 04.10.201. P

Planet dhe Rregulloret mund t’i gjeni në web-faqen e Komunës së Prishtinës